



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA THEMELORE E GJILANIT**  
OSNOVNI SUD GNJILANE – BASIC COURT OF GJILAN

---

**P.nr. 550/2023**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm**, përmes gjyqtarit Behar Ymeri, me bashkëpunëtorin profesionale Kadishe Ajvazi Demi, në lëndën penale kundër të pandehurit A.C...nga fshati Ll..., komuna e Gj..., për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 17 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.1050/2023, të datës 31.07.2023 dhe kërkesës për dhënien e urdhrorit ndëshkimor PP.II.nr.1050/2023, të datës 31.07.2023, më datën 07.08.2023, mori këtë :

**A K T G J Y K I M**

**PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, për dhënien e urdhrorit ndëshkimor ndaj të pandehurit: A.C.. nga fshati Ll..., komuna e Gj..., i lindur më ..., me numër personal:..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**Është fajtor**

Më datën 04.05.2023, në kohë të pa përcaktuar, në shtëpinë e tij në fshatin L., komuna e Gj..., i pandehuri, si shfrytëzues i energjisë elektrike me qëllim që vetit t'i sjellë përfitim të kundërligjshëm pasuror, fillimisht njehsori elektrik i është qkyqur me komand nga distanca për shkak të borxhit ndaj KEDS-it, mirëpo, i pandehuri pa leje dhe autorizim, ka bërë lidhjen e drejtpërdrejtë në rrjetin elektrik, në atë mënyrë që i njëjti ka furnizuar me energji elektrike pajisjet elektrike, përmes të cilave është shpenzuar energji elektrike në mënyrë të paautorizuar, me cka është pamundësuar regjistrimi i shpenzimeve të energjisë elektrike, në këtë mënyrë të dëmtuarës KEDS-in, Distrikti në Gjilan, i ka shkaktuar dëm material në shumë prej 280 euro e 65 cent.

Me këtë ka kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 17 të KPRK-së.

Andaj, në bazë të dispozitës së lartë cekur ligjore dhe neneve 4, 38, 43, 45,69,70,71, dhe 72 të KPRK, dhe nenit 495 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të pandehurit i shqipton,

## **DËNIM ME GJOBË**

Ashtu që i akuzuari **A.C...** dënohet me dënim me gjobë në shumë prej 100 € (njëqind euro) të cilin dënim është i obliguar që ta paguajë brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari refuzon të paguajë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguaj atë atëherë dënimi me gjobë me pajtimin me të akuzuarin do të zëvendësohet me punë në dobi të përgjithshme ashtu që 8 (tetë) orë të punës do të barazohen me 20 € (njëzet euro) ndërsa nëse i akuzuari nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë me punë në dobi të përgjithshme atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim.

E dëmtuara KEDS-i, Distrikti në Gjilan, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontëst të rregullt civil.

Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas llogarisë përfundimtare, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor, të paguajë shumën prej 20 €, brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehurit A.C...nga fshati Ll..., komuna e Gj..., për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 17 të KPRK-së. Gjithashtu Prokuroria Themelore në Gjilan, ka paraqitur kërkesë për dhënjen e urdhërit ndëshkimorë, sipas të cilit të pandehurit ka kërkuar që t'i shqiptohet dënim me gjobë, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ngase janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë.

Gjyqtari, pasi shikoi dhe analizoi aktakuzën, kërkesën për lëshimin e urdhrit ndëshkimor dhe gjitha shkresat e tjera të lëndës, konstatoi se duhet të pranohet kërkesa e Prokurorisë Themelore për dhënien e urdhërit ndëshkimorë ndaj të pandehurit A.C...nga fshati Ll..., komuna e Gj... dhe të pandehurit i shqiptoi dënim me gjobë, ngase të dhënat e paraqitura në aktakuzë dhe provat e bashkangjitura, ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhrit ndëshkimor.

Gjendja faktike vërtetohet: procesverbali me numër 2100653, i datës 04.05.2023, ID e rastit 475278 i datës 05.05.2023, të lëshuar nga departamenti për konsumator-sektori i rikthimit të humbjeve, distrikti në Gjilan, fatura DGLHP 2313447, e datës 05.05.2023, foto dokumentacioni nga vendi i ngjarjes, si dhe shkesa të tjera të lëndës, vërtetojnë se i pandehuri i lartcekur ka kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 17 të KPRK-s në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjykata e ka pranuar kërkesën e Prokurorisë Themelore dhe ndaj të pandehurit, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ka shqiptuar dënim me gjobë, ngase sipas bindjes së kësaj gjykate, dënimi me gjobë është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë së tij, si dhe me caktimin e dënimit me gjobë do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 38 të KPRK.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 452 paragrafi 1 të KPP, kurse vendimi mbi kërkesën pasurore juridike, është marrë duke u bazuar në nenit 462 paragrafi 2 të KPP.

Nga të cekurat e më lartë dhe në bazë të nenit 495 të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**P.nr.550/2023, Më 07.08.2023**

**Bashkëpunëtore profesionale,**  
**Kadishe Ajvazi Demi**

**Gjyqtari,**  
**Behar Ymeri d.v**

**KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri ose mbrojtësi i tij, mund të paraqesin kundërshtim në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit.